



Inteligjenca Artificiale: Superfuqia e brezit të ri

DORACAKU PËR NDËRGJEGJËSIMIN E TË RINJVE
RRETH INTELIGJENCËS ARTIFICIALE

SIMS



Inteligjenca Artificiale (IA) po ndryshon mënyrën se si jetojmë, punojmë dhe mësojmë.

Ajo nuk është më një koncept i së ardhmes, por një realitet i përditshëm.

Për të rinjtë, të kuptuarit dhe përshtatja me këtë teknologji është thelbësore për të ndërtuar një të ardhme të suksesshme.

Çfarë është Inteligjenca Artificiale?

IA është një fushë e shkencës kompjuterike që synon krijimin e sistemeve që mund të mësojnë, arsyetojnë dhe marrin vendime ashtu si njeriu.

Aplikacionet e saj janë të pafundme, duke përfshirë:

Asistentët virtualë (Siri, Alexa)

Automatizimi i proceseve në industri

Analiza e të dhënave për bizneset

Mjekësia dhe diagnozat e avancuara

Automjete autonome, etj.



Trendët e fundit në IA

1 IA Gjenerative

Teknologji si ChatGPT dhe DALL·E që krijojnë tekste, imazhe dhe video.

2 Automatizimi i punës

Shumë profesione po transformohen nga përdorimi i algoritmeve të zgjuara.

3 Etika dhe transparenca

Debati rreth përdorimit etik të IA dhe mbrojtjes së të dhënave personale.



4 IA në arsimin online

Platforma që personalizojnë mësimin bazuar në nevojat e studentëve.

“Inteligjenca artificiale është një teknologji e thellë "po aq e rëndësishme ose më shumë se zjarri dhe energjia elektrike”

Sundar Pichai - Alphabet



Pse është e rëndësishme për të rinjtë?

Aftësitë e reja

Mësimi i kodimit, analizës së të dhënave dhe përdorimit të mjeteve të IA ju bën më konkurrues në tregun e punës.

Inovacioni dhe kreativiteti

IA nuk zëvendëson krijimtarinë njerëzore, por e fuqizon atë.

Zhvillimi i karrierës

Fusha të reja si shkenca e të dhënave, robotika dhe zhvillimi i algoritmeve janë profesione të së ardhmes.

Si mund të përgatiteni për të ardhmen?

Edukimi dhe kurset online

Ndiqni kurse në platforma si Coursera, Udemy dhe edX për të mësuar mbi IA.

Praktika dhe projekte

Bashkohuni në gara teknologjike, si hackathon-et apo projekte me bazë IA.



Rrjetëzimi

Lidhu me profesionistë dhe entuziastë të teknologjisë përmes konferencave dhe forumeve online.




Krijoni një portofolio

Ndërtoni projekte praktike që tregojnë aftësitë tuaja në programim dhe IA.

Hapësirat për të rinjtë për t'u angazhuar me inteligjencën artificiale janë thelbësore për zhvillimin e tyre profesional dhe krijimin e mundësive të reja.

Këto mjedise u mundësojnë të mësojnë, eksperimentojnë dhe të zhvillojnë ide inovative, duke i përgatitur për sfidat dhe tregun e së ardhmes.

Në vazhdim ju sjellim disa mundësi që ofron Prishtina >>>





Qendra e Inovacionit në Kosovë (ICK) është një qendër që synon të lidhë komponentin e kërkimit dhe zhvillimit të fushës shkencore me sektorin e biznesit, duke u fokusuar në krijimin e mundësive të reja të punës të orientuara drejt së ardhmes, bazuar në njohuri dhe teknologji të re.



Qendra e Inovacionit në Kosovë (ICK) u themelua për të mbështetur ndërmarrësinë, inovacionin dhe zhvillimin e biznesit me bazë komerciale, me fokus në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Qendra mbështet si kompanitë fillestare ashtu edhe ato ekzistuese me potencial për rritje.



BONEVET është institucion i edukimit joformal që inkurajon fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit të identifikojnë dhe zhvillojnë talentet dhe aftësitë e tyre përmes lojës dhe teknologjisë. BONEVET është themeluar në vitin 2014 në Gjakovë nga Fondacioni UNË E DU KOSOVËN si organizatë joqeveritare dhe joprofitabile, me status të përfituesit publik.



BONEVET është dizajnuar për të stimuluar kuriozitetin, imagjinatën dhe kreativitetin e fëmijëve dhe të rinjve. Ata inkurajohen që të mësojnë përmes lojës dhe teknologjisë, të krijojnë lojërat e veta, të programojnë robotë, të bëjnë prototipe me 3D printer, të punojnë së bashku me tjerët, të zgjidhin gjëegjëza dhe mistere të ndryshme, të zhvillojnë shkathtësitë e komunikimit, të lexojnë libra dhe të mësojnë gjuhë të huaja.

PRISHTINA HACKERSPACE

Prishtina Hackerspace është një hapësirë bashkëpunuese dhe e hapur eksperimentale e bazuar në komunitet, e krijuar për qëllime teknologjike, arsimore, kulturore dhe shkencore. Kjo hapësirë prej shumë vitesh shërben si ambient pune për studentët.



Hackerspace është një mjedis i hapur pjesëmarrjeje ku njerëz të të gjitha moshave dhe nga disiplina të ndryshme mësojnë praktikisht në një mënyrë bashkëpunuese dhe argëtuese duke bërë prototipa dhe duke ndërhyrë me pajisjet, duke marrë pjesë në konkurse ndërkombëtare ose duke bërë projekte ambicioze nga makinat fluturuese deri te hakerimi i biologjisë.




***“E ardhmja i përket atyre
që përgatiten sot.”***

Malcolm X

Gati 60% e bizneseve planifikojnë të rrisin investimet në AI në vitin 2025


Pavarësisht shqetësimeve për sigurinë dhe dilemave etike në përdorimin e AI, 60% e kompanive ende planifikojnë të rrisin investimet e tyre në këtë fushë gjatë vitit të ardhshëm. Kjo është veçanërisht e theksuar tek bizneset në sektorët e logjistikës dhe shërbimit ndaj klientit.



Inteligjenca artificiale pritet të krijojë 133 milionë vende të reja të punës deri në vitin 2030

Roli i specializuar i AI dhe të dhënave të mëdha (big data) pritet të rritet me 30-35% për shkak të rëndësisë së tyre në zhvillimin e zgjidhjeve të AI. Këto role përfshijnë shkencën e të dhënave (data science), mësimin makinerik (machine learning), përpunimin e gjuhës natyrore (natural language processing), dhe shikimin kompjuterik (computer vision).

31% e bizneseve po punësojnë aktivisht ekspertë të AI, ndërsa 27% tashmë kanë krijuar role të reja specifike për AI, duke theksuar më tej kërkesën në rritje për profesionistë të kualifikuar në këto fusha.



***“Mos prit që mundësitë
të vijnë tek ty. Krijoj ato!”***

Chris Grosser





**Deri në vitin 2030,
30% e orëve të punës në
ekonominë amerikane mund
të automatizohen me AI**

Rreth 75% e bizneseve do të përqafojnë tregtinë elektronike dhe digjitale

Teknologjitë si të dhënat e mëdha (big data), (cloud computing) dhe AI pritet të kenë norma të larta adoptimi për shkak të potencialit të tyre për të përmirësuar operacionet digjitale të bizneseve.

Për më tepër, 86% e kompanive të anketuara planifikojnë të integrojnë platforma dhe aplikacione në operacionet e tyre gjatë pesë viteve të ardhshme.

75%

Mjetet më të mira të produktivitetit të AI në 2025 sipas kategorisë:

Chatbots (ChatGPT, Claude, Meta AI, Zapier Agents)

Search engines (Perplexity, Google AI Overviews, Arc Search)

Content creation (Jasper, Anyword, Writer)

Grammar checkers and rewording tools (Grammarly, Wordtune, ProWritingAid)

Video creation and editing (Runway, Descript, Wondershare Filmora)

Image generation (DALL·E 3, Midjourney, Ideogram)

Social media management (FeedHive, Vista Social, Buffer)

Voice and music generation (ElevenLabs, Suno, AIVA)

Knowledge management and AI grounding (Mem, Notion AI Q&A, Personal AI)

Task and project management (Asana, Any.do, BeeDone)

Transcription and meeting assistants (Fireflies, Avoma, tl;dv)

Scheduling (Reclaim, Clockwise, Motion)

Email (Shortwave, Microsoft Copilot Pro for Outlook, Gemini for Gmail)

Slide decks and presentations (Tome, Beautiful.ai, Slidesgo)

Resume builders (Teal, Enhancv, Kickresume)

Automation (Zapier)

E ardhmja është në duart tuaja!

Inteligjenca Artificiale është një mjet i fuqishëm që ju mund të përdorni për të ndërtuar një karrierë të suksesshme dhe për të krijuar ndikim pozitiv në shoqëri.

Mos kini frikë nga teknologjia, por bëjeni atë aleatin tuaj më të fortë.



Ky doracak është përgatitur nga SIMS Marketing Agency – agjencia juaj e besuar për zgjidhje kreative në marketing.

Për më shumë informata dhe mundësi bashkëpunimi, na ndiqni në www.sims-ks.com apo në rrjetet sociale ose na kontaktoni në info@sims-ks.com

